

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**“DigitaLink” sh.p.k**

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 24/07/2023, Themeluesi:

1. **Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

## **Neni 1-Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është

**“DigitaLink” sh.p.k**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëhërë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

## **Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

**Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet:** Durrës , Lagjja nr14,Rruga Bajram Tusha, Shkozet , Nr,Pasurie 100-7433, Durres

## **Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

#### Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

1. Shitjen me shumice e pakice te artikujve te ndryshem. 2. Programime software dhe zgjidhje nepermjet teknologjise se informacionit. Sherbime dizajni dhe grafiku. 3. Sherbime audio dhe video. 4. Sherbime marketingu, printime, online, reklama 3D etj. 5. Konsulence te ndryshme lidhur me fushat e marketingut dhe telemarketingut.

#### Neni 5- Kapitali Themeltar

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 500.000 (Peseqind mije) leke.**

Kapitali themeltar është i perberë nga 1 (Nje) kapital i vetëm me vlerë nominale 500.000 (Peseqind mije) leke.

#### Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

**1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 500.000 (Peseqind mije) leke.**

Kapitali themeltar është i perberë nga 1 (nje) kapital i vetëm me vlerë nominale 500.000 (Peseqind mije) leke.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesiperme eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortakët e shoqërisë perkatesisht:

1. **Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M, vlera e kapitalit te pergjithshem **500.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqërisë perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë

#### Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretteve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

#### Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.

2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i vetëm i shoqërisë është Skerdian Kacuqi**, Lindur në Durres me 29.07.1990 ,me nr personal J00729066M.
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

#### **Neni 9- Të tjera**

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **Neni - 10**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpëdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

#### **Neni - 11**

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Durres , më 24/07/2023.*

**ORTAKU I SHOQERISE**

**SKERDIAN KACUQI**

*Skerdian Kacuqi*

